



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 390/2 Prot.

Tiranë, më 31.03.2026

V E N D I M

Nr. 64, Datë 31.03.2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën nr. 54 Regj, datë 23.02.2026, të znj. B. D² kundër Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjuhës”, “shtetësisë”, “gjendjes arsimore” “vendbanimit”, “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas pretendimeve dhe shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me email-in datë 24.02.2026, subjekti ankues informon se:

“Më datë 05.08.2025, një takim i nivelit të lartë (MAS dhe Zyra e Kryeministrit) përcaktoi që Diploma Ndërkombëtare e Bachelorit të B. D është sipas nenit 52/3, të ligjit nr. 69/2012, nen i cili përcakton, rast pas rasti, nëse dokumenti i një studenti ndjek rrugën e maturës në Shqipëri (nenin 52/1, i Ligjit) apo rrugën e diplomës së huaj (neni 52/4, i Ligjit). Takimi arriti në përfundimin se diploma e saj i përket rrugës së huaj dhe udhëzoi QSHA-në ta nostrifikojë atë.”

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Përfaqësuar nga i ati z. J. D, (nënshtetas Australian), sipas deklaratës me shkrim të depozituar nga ankuesja nëpërmjet e-mailit datë 24.02.2026, pranë KMD-së.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

QSHA ka refuzuar të zbatojë këtë udhëzim, duke këmbëngulur që B. D të japë provimin e maturës shqipe – një kërkesë që ligjërisht është e pamundur (ajo nuk ka mësuar asnjëherë në gjuhën shqipe) dhe është zbatuar në mënyrë arbitrare.

Studentët me diploma identike IB, të lëshuara nga i njëjti organ në Gjenevë pranohen, nëse kanë jetuar jashtë vendit gjatë vitit të tyre të fundit, por refuzohen nëse kanë jetuar në Shqipëri.

Ky trajtim diferencial bazuar në vendbanim, gjuhë dhe gjendje arsimore është diskriminim i paligjshëm.

Një ankesë e mëparshme është paraqitur pranë Zyrës tuaj (KMD-së) për të cilën është dalë me Vendimin nr. 165, datë 14.07.2025, i cili gjeti “një boshllëk procedural”, por jo shkelje. Ky konstatim adresohet dhe zëvendësohet nga faktet e reja dhe sqarimet në këtë ankesë, duke përfshirë udhëzimin e dhënë për QSHA, gjatë takimit të datës 05.08.2025 dhe refuzimin pasues të QSHA-së.”

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkaqet e pretenduara, nga QSHA; të urdhërohet QSHA, të ndërpresë diskriminimin dhe të zbatojë udhëzimin e datës 05.08.2025, për njehsimin e Diplomës IB, të apostiluar të B. D; si dhe të urdhërohet QSHA, të miratojë një procedurë jo diskriminuese për njohjen e Diplomave IB, të lëshuara nga shkollat private të licencuara në Shqipëri.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë

baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, konstatohet se:

Së pari, ankesa aktuale (me nr. 54 regj., datë 23.02.2026) e depozituar nga shtetasja australiane B. D, është në vijim të problematikës së paraqitur nëpërmjet ankesës së regjistruar gjatë vitit 2025, me nr. 151 regj, datë 01.07.2025.

Në ankesën sipërcituar, paraqitet problematika e saj si vijon:

Në vitin shkollor 2024-2025, ankuesja ka ndjekur dhe ka përfunduar klasën e 12-të, në programin në gjuhën angleze, në shkollën e mesme “Akademia Botërore e Tiranës”. Ankuesja ka dashur të regjistrohet në një program studimi bachelor, në një institucion të arsimit të lartë në Tiranë, por i kanë kërkuar ekuivalentimin e diplomës së shkollës së mesme, dhe për këtë arsye i është drejtuar me email Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

QSHA me email-in datë 09.06.2025, i është përgjigjur si vijon: “*Ju informojmë se ne kryejmë ekuivalentimin e diplomave të huaja që kanë përfunduar shkollën jashtë territorit shqiptar, ndërsa ju keni përfunduar shkollën e mesme në “Akademinë Botërore të Tiranës” (World Academy of Tirana), e cila është një shkollë që ushtron aktivitetin e saj brenda territorit të Shqipërisë, ekuivalentimin e së cilës ne nuk e kryejmë”.*

Pala ankuese në ankesën objekt shqyrtimi, kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe ti rekomandojë, MAS dhe QSHA, përjashtimin nga detyrimi për dhënien e provimeve të maturës shtetërore për të gjithë studentët e huaj me Diplomë IB.

Lidhur me sa më sipër, nëpërmjet Vendimit nr. 165, datë 14.07.2025, Komisioneri ka disponuar me mospranimin e ankesës nr. 151, datë 01.07.2025, të paraqitur nga znj. B. D, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, duke arsyetuar, ndër të tjera, se:

“Në ligjin 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”, të ndryshuar, në nenin 51, ka të përcaktuar se arsimi i mesëm i lartë përfundon me provimet e maturës shtetërore. Ndërkohë, që

në nenin 4, të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, të ndryshuar, përcaktohet se individët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë të cilët plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi, kanë të drejtë për të ndjekur arsimin e lartë.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se ankuesja ka ndjekur procesin mësimor në institucionin mësimor “Akademia Botërore e Tiranës”, por nuk i është nënshtruar provimeve të maturës shtetërore, dhe në këto kushte, rezulton se ankuesja nuk ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë, sipas përcaktimeve të nenin 51, të ligjit 69/2012, të ndryshuar.

Gjithashtu dhe QSHA-ja, referuar Udhëzimit 13/2023, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, nuk ka autoritetin për të shqyrtuar aplikimet për ekuivalentimin e diplomave të lëshuara nga institucionet arsimore të Republikës së Shqipërisë.

Në legjislacionin e sipërcituar, nuk ka asnjë dispozitë, në të cilën të parashikohet ekuivalentimi i diplomave të fituara në institucionet arsimore parauniversitare, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, në gjuhë të huaj, si dhe pranimi në programet e studimit të arsimit të lartë, për studentët të cilët kanë përfunduar procesin mësimor në një shkollë të mesme në Shqipëri, por nuk kanë janë të pajisur me diplomë të maturës shtetërore.

Në këtë kuptim dhe kërkesa e subjektit ankues për ekuivalentimin e përfundimit të shkollës “Akademia Botërore e Tiranës”, drejtuar Qendrës së Shërbimeve Arsimore, nuk mund të shqyrtohej nga këto të fundit, pasi kërkesa për ekuivalentim, është e panormuar nga legjislacioni shqiptar.

.....

Një ligj i cili vjen në kundërshtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, është një ligj i cili nuk është në përputhje me Kushtetutën, por gjykimin dhe vlerësimin për një gjë të tillë mund ta bëjë vetëm Gjykata Kushtetuese, si i vetmi autoritet i autorizuar nga Kushtetuta për të vendosur në lidhje me pajtueshmërinë e një ligji me Kushtetutën.

Sa më sipër, konstatimi nëse një ligj është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është një kompetencë që Kushtetuta i'a ka njohur vetëm Gjykatës Kushtetuese dhe se asnjë institucion tjetër shtetëror, përfshi edhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi..”

Së dyti, lidhur me pretendimin se në ankesën aktuale të regjistruar pranë KMD-së, (me nr. 54 regj., datë 23.02.2026) ka depozituar elementë e fakte të reja, Komisioneri vlerëson se:

Në shkresën e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, drejtuar z. J. D, me datë 05.08.2025, ndër të tjera, citohet se: “Më datë 05.08.2025, në MAS, u zhvillua një takim me z. J. D dhe përfaqësuesve të MAS, në lidhje me ankesën që ka paraqitur në platformën e bashkëqeverisjes, për mosregjistrimin e vajzës së tij B. D në IAL e Republikës së Shqipërisë, për shkak se është pajisur me diplomë të shkollës së mesme, lëshuar nga IA “Akademia Botërore e Tiranës” (World Academy

of Tirana/WAT) dhe nuk ka kryer provimet e maturës shtetërore. Në përfundim të takimit u dakordësua si vijon:

Në rast se z. D paraqet një dokument diplomë të arsimit të mesëm, lëshuar nga institucionet arsimore parauniversitare të huaja, do t'i drejtohet QSHA-së, për njësimin e diplomës dhe për vijimin e procedurave për regjistrim IAL.

Në rast se vajza e z. D nuk disponon një diplomë të arsimit të mesëm të lëshuar nga një shtet i huaj, por ka vetëm diplomën e lëshuar nga IAP "Akademia Botërore e Tiranës/WAT", bazuar në legjislacionin shqiptar për arsimin parauniversitar, në këtë rast, nxënësja duhet të japë provimet e maturës shtetërore dhe të pajiset me diplomën e maturës, lëshuar nga QSHA, për të pasur të drejtë të regjistrohet në IAL-të e Republikës së Shqipërisë."

Më datë 28.08.2025, z. D ka dërguar kërkesë për njëvlefshmërinë e diplomës së shkollës së mesme "Akademia Botërore e Tiranë", të B. D, pranë QSHA, si dhe ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë citohet:

- Duplikatë të Diplomës IB, lëshuar nga Diploma Ndërkombëtare e Bakalaureatit, Gjenevë (25 korrik 2025), përkthyer në shqip, si vijon: "Vërtetojmë se B. D, e paraqitur nga institucioni shkollor i quajtur World Academy of Tirana, ka marrë Diplomë të Maturës Ndërkombëtare"
- Duplikatë të Diplomës IB, lëshuar nga Diploma Ndërkombëtare e Bakalaureatit, Gjenevë (13 gusht 2025), përkthyer në shqip, si vijon: "Vërtetojmë se B. D, e paraqitur nga institucioni shkollor i quajtur World Academy of Tirana, ka marrë rezultate në vijim: M 23 Fizikë (Angl) SL 5";
- Transkriptin Apostil IB, lëshuar nga i njëjti institucion për lëndët standarde.

Me shkresën me nr. 4035/1 prot., datë 18.09.2025, QSHA, ka informuar z. J. D se:

"Ju bëjmë me dije se, në bazë të Udhëzimit nr. 13, datë 30.06.2023, të MAS "Për Përcaktimin e Kritereve dhe Procedurave të Njëvlefshmërisë së Dëftesave dhe Diplomave të nxënësve të Arsimit Parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit", i ndryshuar, në Kreun I, pika 1, citohet si më poshtë:

*Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë së diplomës së arsimit të mesëm të lartë të **fituar jashtë vendit**, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin parauniversitar, Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës, sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).*

Në pikën 6/a), përcaktohet se: "QSHA-ja dhe ZVPA-ja nuk shqyrtojnë aplikimet për rastet si mëposhtë: a) Diploma/dëftesa të arsimit parauniversitar, **të fituara në Republikën e Shqipërisë**".

Për rastet e përmendura në këtë pikë të Udhëzimit, aplikanti njoftohet zyrtarisht për mosshqyrtimin e aplikimit.”

Referuar sa më sipër, evidentohet se, arsyeja e mosshqyrtimit të aplikimit të znj. B. D lidhur me njëvlefshmërinë e diplomës së saj IB, paraqitur nga shkolla e mesme private “Akademia Botërore e Tiranës”, është për shkak të konsiderimit të diplomës “e fituar në Republikën e Shqipërisë”, gjë e cila, sipas parashikimit të pikës 6/a, të Udhëzimit nr. 13, datë 30.06.2023, të MAS “Për Përcaktimin e Kritereve dhe Procedurave të Njëvlefshmërisë së Dëftesave dhe Diplomave të nxënësve të Arsimit Parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, i ndryshuar, përbën ndalim/pengesë ligjore, nisur nga përcaktimi i togfjalëshit **“të fituara në Republikën e Shqipërisë”**

Për rrjedhojë, nisur nga sa më sipër, Komisioneri çmon se, në kuadër të kësaj ankese, nga subjekti ankues nuk janë depozituar elementë apo prova që të konsiderohen si të reja, të cilat të afektonin thelbin e çështjes, pasi në të dyja përgjigjet/rastet, QSHA mban qëndrimin se, pavarësisht se diploma në fjalë njihet si diplomë mature ndërkombëtare/IB, ajo është diplomë e **fituar në Republikën e Shqipërisë**. Për rrjedhojë, QSHA-ja nuk shqyrtton aplikimet për rastet e Diploma/dëftesa të arsimit parauniversitar, të fituara në Republikën e Shqipërisë⁴.

Në këtë kontekst, rezulton se pretendimet e parashtruara sërish në ankersën me nr. 54/2026, janë shqyrtuar nga Komisioneri, në kuadër të ankesës të mëparshme me nr. 151/2025, për të cilën Komisioneri është shprehur me vendimin respektiv, si dhe nuk është depozituar asnjë provë apo fakt i ri për të filluar trajtimin e një çështjeje, shqyrtimi i së cilës për më tepër ndodhet jashtë kompetencave që LMD i atribuon Komisionerit.

Për sa më sipër, Komisioneri, mbështetur në nenin 33, pika 4/c, të LMD, i cili përcakton se: “Ankesa nuk pranohet nëse e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja”, gjykon se pretendimet e znj. B. D për diskriminim nga QSHA, nuk mund të pranohen për shqyrtim, pasi Komisioneri është shprehur me vendim të mëparshëm për të njëjtat pretendime të saj⁵.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a dhe nenin 33, pikat 1 dhe 4/c të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁴ Pika 6/a, e Udhëzimit nr. 13, datë 30.06.2023, të MAS “Për Përcaktimin e Kritereve dhe Procedurave të Njëvlefshmërisë së Dëftesave dhe Diplomave të nxënësve të Arsimit Parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, i ndryshuar.

⁵ Për analogji shih vendimet me: nr. 54, datë 01.04.2021; nr. 73, datë 07.05.2021; nr. 65, datë 27.04.2023; nr. 163, datë 14.08.2023; nr. 265, datë 28.12.2023, të KMD-së.

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës me nr. 54 Regj., datë 23.02.2026, të B. D, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA